

Specifikimet teknike

Grumbullimi dhe Transportimi i Mbetjeve Urbane

Volumet e punimeve dhe frekuenca e shërbimit

Autoriteti kontraktues për llogaritjen e kostonë së grumbullimit dhe transportit të mbetjeve ka zbatuar modelin e llogaritjes së kësaj kostoje konform shtojcës 1 të zbatuar VKM Nr. 319, datë 31.5.2018 "Për Miratimin e Masave Për Kostonë e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve."

Duke u bazuar në ligjin nr. 162 dt 23.12.2020 "Për Prokurimin publik", neni 34, pika 9 shprehet: "Për kontratat shumëvjeçare ose kontratat me mundësi ripërtëritjeje, autoriteti ose enti kontraktor duhet të parashikojë klauzola për rishikimin e vlerës në përputhje me inflacionin e publikuar. Në rastet e kontratave të furnizimit të mallrave, përmes girasë me ose pa mundësi blerje të mallrave, fondi limit llogaritet duke përfshirë giranë apo kostonë mujor, shumëzuar me numrin e muajve gjatë të cilëve do të zgjasë kontrata"

Në llogaritje është vendosur edhe norma baze e inflacionit sipas Bankes së Shqipërisë ku norma baze e inflacionit është në ulje dhe për periudhën Janar - Mars 2025 norma mesatare e këtyre muajve është 2.1%. Muaji i fundit (mars 2025) ishte 2.3%. Jam bazuar në normën mesatare të 3 tre muajve të vitit 2025. Kjo normë do llogaritet në vitet në vijim duke u bazuar në normën mesatare të inflacionit sipas Bankes së Shqipërisë për periudhat e Janar - Mars.

Duke njohur terrenin dhe problemet që shfaqen në këtë shërbim Bashkia Kavajë si Autoritet kontraktor ka gjykuar si më poshtë :

- Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve të kryhet në frekuencën 3 herë në javë ose 156 ditë në vit.
- Gjatë periudhës turistike 15 qershor-15 shtator të kryhet një shërbim shtesë për të përballuar sasinë e lartë të mbetjeve që gjenerohen gjatë kësaj periudhe ku numri i turistëve që akomodohen në Njësinë Administrative Golem i kalon 100000. Për ky shërbim shtesë do të kryhet çdo ditë përgjatë kësaj periudhe ose 93 ditë në vit. Për efekt llogaritje të mesatarizuar ky numër është llogaritur në 90000.
- Mbetjet e grumbulluara do të depozitohen në landfillin e Sharrës Tiranë.
- Autoriteti kontraktor pas llogaritjeve sipas VKM 319 ka konkluduar si më poshtë:
 - Numri i konteinerëve për periudhën vjetore është 144 konteinerë të kapacitetit 1700 litra të vendosura në të gjithë territorin e Njësisë Administrative Golem të ndara në 86 pika grumbullimi
 - Numri i konteinerëve që do të vendosen për periudhën turistike do të jetë 529 konteinerë të kapacitetit 1700 l, të shtuara pranë pikave ekzistuese të grumbullimit të mbetjeve si edhe në vendet ku këto mbetje gjenerohen në sasi të konsiderueshme (Resorte turistike, hotele, restorante etj)
 - Përzgjedhja e kapacitetit mbajtës së makinave është bërë duke konsideruar infrastrukturën rrugore, tipologjinë e zonës, ngarkesën e trafikut , periudhën e shërbimit si edhe të dhëna të tjera historike në lidhje me shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në këtë zonë.

Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe transportit të mbetjeve urbane konsiston në:

1. Zbrazjen e kontenierëve dhe ngarkimin e mbetjeve të depozituara në këto konteinerë në makinën e përshtatshme teknologjike të përcaktuar.
2. Mbledhjen dhe largimin e mbetjeve të hedhura përreth në një distancë me rreze prej 10 m nga çdo kontenier.
3. Rivendosjen e kontenierëve të sistemuar në vendin e caktuar. Kontenierët duhet të vendosen drejt, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike për mjedisin urban. Më pas makinat teknologjike kryejnë transportin e mbetjeve në fushën e depozitimit të tyre.
4. Dezinfektimin në përfundim, me pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori, brenda çdo kontenieri.
5. Transportimin e mbetjeve deri në vendin e përcaktuar që për NJA Golem është landilli i Sharrës (Tiranë)

Plani i vendosjes së kontenierëve dhe grafikët e punimeve

- a) Autoriteti kontratues ka përcaktuar në fillim të kësaj kontrate pikat ekzakte të grumbullimit të mbetjeve urbane, dhe numrit të kontenierëve për secilën pikë, në të gjithë zonën e kontraktuar.
- b) Operatori i shërbimit është i detyruar të zbatojë planin fillestar të pikave dhe kontenierëve të kërkuar (harta bashkëngjitur specifikimeve teknike) si dhe çdo ndryshim të tyre përgjatë kohës së zbatimit të kësaj kontrate. Ky plan mund të ndryshojë gjatë kohës së zbatimit të kontratës nga operatori i shërbimit ose nga Autoriteti kontratues sipas nevojave për përmirësimin e shërbimit dhe mirë organizimit të tij, ose si rezultat i ndryshimeve që mund të ndodhin në infrastrukturë gjithmonë pas kërkesës të njëjës palë dhe bëhen të zbatueshme pas miratimit të Autoritetit kontratues.
- c) Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, pregatiten nga operatori i shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontratues. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë: 1. Oraret e operimit në secilën pikë kontenierësh. 2. Llojin, targën dhe intenerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin. 3. Oraret e operimit dhe mjetet për shërbimet mbështetëse. 4. Numrin e punëtorëve që do të mbështesin çdo operacion punimesh.
- d) Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit.
- e) Grafikët për largimin e mbetjeve që do të paraqiten për miratim, duhet të pregatiten në mënyrë të tillë që të gjitha punimet të kryhen brenda orëve të natës, duke filluar jo më parë se ora 18.00, me qëllim që në orën 06.00 zona e kontraktuar të jetë krejtësisht e pastër. Ndryshimet në orarin e operimit dhe përfundimit të shërbimit në zonë, do të pranohen vetëm për shkak të

pamundësisë objektive të kryerjes së shërbimit të parashikuar si dhe në rastet e ndryshimit të orarit për rrugët tregtare, por gjithmonë pasi të jenë verifikuar dhe miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontratues, ndryshimet në Grafikon e Punimeve.

- f) Autoritetit kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbetjeve për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur ndalesa, penalitete dhe gjopa për mospërbushjen e tyre.

Rregulla për tu zbatuar

- a. Për asnjë rast nuk do të lejohen kazanë të tejmbushur me mbeturina, të patransportuara dhe mbeturina të lëna në zonen përreth kontenierëve. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 3 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik.
- b. Operatori i shërbimit ka për detyrë të kryejë grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane që depozitohen në ambiente publike brenda zonës së kontraktuar edhe në rast se hidhen larg pikave të miratuara të grumbullimit të tyre. Në rastet kur mbetjet hidhen në mënyrë të përsëritur operatori i shërbimit ka të drejtë të kërkojë miratimin e vendosjes së kontenierëve dhe përfshirjen në grafikun e punimeve.
- c. Operatori i shërbimit duhet të informojë me shkrim Autoritetin kontratues në mënyrë periodike për të gjitha kontratat private të pastrimit që do ketë me të tretë, të reklamojë numrin e mjeteve dhe punëtorë shtesë për këto shërbime për të garantuar cilësinë e kërkuar të shërbimeve në kontratën me Autoritetin kontratues. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, pajisjeve.
- d. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve të transportit dhe shoferëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.
- e. Nëqoftë se gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojë kontraktori për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve të rëna gjatë transportit, ai do të përballë me penalitetet e parashikuara në përputhje me këtë kontratë apo me gjopa të tjera në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.
- f. Përdorimi i uniformave për punëtorët që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyrueshëm dhe në rast mosbatimi aplikohen gjopa për mosplotësim këtij detyrimi. Cdo punëtor duhet të jetë i pajisur me uniformë dalluese pune fosforeshente duke qene qe jane te ekspozuar ndaj levizjes se automjeteve apo aksidenteve te mundshme rrugore

Mjetet dhe pajisjet

Makinat e nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve urbane të kërkuara për këtë shërbim, të cilat kanë dalë nga llogaritjet sipas VKM 319 VKM Nr. 319, datë 31.5.2018 “Për Miratimin e Masave Për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, jepen sipas tabelës nr 3. Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, (mbledhjes, transportit, largimit të mbetjeve) dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

Për NJA Golem pergjatë gjithë vitit:

10(dhjetë) makina teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve(Kompatator), me ngarkim fundor ose anësor, me raport kompaktimi 1:4 - 1:6., me kapacitet mbajtës 7-8 Ton.

Makinat duhet të jenë Euro 5 në funksion të sensibilitetit të zonës dhe periudhës turistike në mënyrë që të emetohet sa më pak CO₂.

1. Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:

- a. Të gjitha automjetet të cilat do të përdoren nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontratues për gjëndjen e gatishmërisë dhe inventarizimin e tyre.
- b. Të gjitha automjetet të cilat do të përdoren, duhet të jenë të identifikuara nga Autoriteti kontratues. Një pjesë e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të jenë gjendje për të siguruar plotësimin e gatishmërisë së mjeteve.
- c. Automjetet e largimit të mbetjeve duhet të lahen dhe dezinfektohen çdo ditë pas përfundimit të punës.
- d. Të gjithë kontenierët e përdorur për zbatimin e kontratës duhet të mbahen të pastër, në gjëndje të mirë teknike. Në rast dëmtimesh, djegiesh, deformimesh të kontenierëve, si dhe dëmtime rrotash dhe kapakësh, të cilat çojnë në mosfunksionimin e plote teknik, higjenik ose estetik të tij gjatë kohëzgjatjes së kontratës si dhe mungesës së kontenierëve, operatori i shërbimit ka përgjegjësinë për ruajtjen, mirëmbajtjen e kontenierëve për çdo rast dhe për çdo shkak.

Fshirja e rrugëve dhe trotuareve me krahë.

Volumet e Punimeve

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët, trotualet dhe sipërfaqet e tyre për të gjithë zonën e kontraktuar. Sipërfaqja totale e tyre është **73542 m²**. Frekuenca e këtij shërbimi do të jetë 182 herë në vit (pra një ditë po dhe një ditë jo).

Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i fshirjes së rrugëve dhe trotuareve me krahë konsiston në:

Fshirjen me punëtorë me fshesë të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve dytësore, duke mbuluar sipërfaqen e plotë të trotuarit dhe një sipërfaqe rruge 1.5 m nga kuletat, në gjithë gjatësinë lineare të saj. Pra sipërfaqe për fshirje do të llogaritet sipas formule : Siperfaqe per fshirje = gjatesi lineare x 1.5 m x 2(krahët e rruges). Ky shërbim përfshin edhe pastrimin e mbetjeve të depozituara jashtë konteinereve (në pikat publike të grumbullimit të tyre) duke i depozituar këto mbetje brenda konteinereve në mënyrë që procesi i ngarkimit të mbetjeve të kërkojë më pak kohë dhe mos bëhet pengesë për kohë të gjatë për qarkullimin e mjeteve të tjera.

Ky shërbim do të kryhet çdo ditë përgjatë 182 ditëve në vit në orarin 24-00-06.00

Plani i punës dhe grafikët e punimeve

- a. Fshirja e rrugëve do të bëhet gjatë natës nga ora 00.00-06.00.
- b. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, përgatiten nga sipërmarrësi dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontratues. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimit të makinave për rrugë të veçanta dhe ditë të veçanta dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontratues këto ndryshime.
- c. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:
 - Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar.
 - Numri i punëtorëve që do të punojnë në çdo operacion punimesh.
- d. Autoriteti kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.

Rregulla për tu zbatuar

- a. Për asnjë rast nuk do të lejohen rrugë të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 3 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik.
- b. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve dhe pajisjeve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.
- c. Gjatë procesit të fshirjes i ndalohet kategorikisht hedhja e mbetjeve në pusetat e elektrikut, telefonisë, të ujësjellësit, ujrave të zeza, hidrantëve, në zgarat e pusetave të ujrave atmosferike, në shtretërit e ujrave rrjedhëse, zonat e gjelbra, burimet ujore natyrore apo artificiale, etj. Në rast të konstatimit të kësaj dukurie operatori i shërbimit detyrohet t'i pastrojë menjëherë.
- d. Ndalohet në mënyrë kategorike ngritja e pluhurit gjatë proceseve të fshirjes për shkak të ndotjes që shkaktojnë.
- e. Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerren gjoka për mosplotësim të tyre.
- f. Gjithashtu punëtorët e pastrimit duhet të përfitojnë trajtim special në përputhje me normat higjienike në fuqi për shkak të llojit të punës që kryejnë.

Mjetet dhe pajisjet

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes me krahë të rrugëve dhe trotuareve si dhe të gjitha shërbimeve plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

- Çdo punëtor duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastike, karroca dore, lopata, etj për të mundur kryerjen me cilësi të shërbimit. (jane te specifikuar ne analizen e kosos për këtë zë punimesh)
- Cdo punetor duhet te jetë i pajisur me uniforma dalluese pune fosforeshente duke qene qe jane te ekspozuar ndaj levizjes se automjeteve apo aksidenteve te mundshme rrugore.
- Punetorët nuk duhet të lejohen të kryejnë procese pune pa qenë te veshur me uniformë.

Shërbimi i larjes së dhe desinfektimit të konteinerëve

Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i larjes së dhe desinfektimit të konteinerëve konsiston në:

Larjen e konteiereve me uje dhe solucion lares dhe dezinfektues për të larguar të gjitha mbetjet e vogla që mund të qendrojnë brenda konteinerit, larguar aromat e keqija, eliminimin e baktereve, si edhe permiresimin e imazhit të zones turistike. Po kështu ky shërbim do të shmangë grumbullimin e brejtesve, kafsheve të rrugës, vektoret(mushkonjave) e insekteve(grereza, miza etj)nga pikat e grumbullimit të mbetjeve, si edhe do të minimizojë rrezikun e përhapjes së baktereve në zonë në periudhën e nxehte.

- *Per 144 konteinere te volumit 1700 litra që janë në funksion pergjate gjithë vitit ky shërbim do të kryhet cdo dite përgjate 156 diteve në vit ne orarin 24-00-06.00.Sasia ditore do te jete 12 cope konteinere të lare në ditë(frekuence 1 here në muaj per cdo konteiner)*
- *Per 529 konteinere te volumit 1700 litra që janë në funksion pergjate periudhes turistike shërbim do të kryhet 30 dite përgjate 93 diteve në vit(gjate periudhes Korrik-Gusht kur ngarkesa e mbetjeve dhe temperaturat janë të larta) ne orarin 24-00-06.00. Sasi ditore do te jete 36 copë.*

Metodologjia e shërbimit: Konteineret e zbrazur do të ngarkohen në një makine vetshkaruese , do të dergohen ne autopark dhe aty do të lahen me uje dhe solucion larës e desinfektues, nese do të konstatohen demtime do të duhet të riparohen përpara se të rikthehen në pikat e grumbullimit të mbetjeve fillestare. Eshte perlllogaritur qe nje cikel i plote per ngarkimin e 6 konteinerëve dhe dergimin ne nje autopark brenda zones se nja Golem është mesatarisht 7 km.(vajtje-ardhje). Operatori per cdo rast duhet të disponojë një sasi rezerve konteineresh per te berë zevendesinim e menjehershëm te sasisë së konteinerëve për tu larë në të njejtin rrugetim të makinës për të rritur eficiencën e shërbimit.

Plani i punës

- Shërbimi i larjes së dhe desinfektimit të konteinerëve do të kryhet gjatë natës nga ora **18.00 - 06.00.(gjithmonë pasi ato të jene boshatisur nga mbetjet pra kur shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve të kete mbaruar në pikat e grumbullimit ku keto konteinerë do të merren për tu larë)**
- Punonjësi që do të kryejë këtë shërbim duhet të jetë i pajisur me mjetet mbrojtëse për të parandaluar cdo dëm në shëndet apo sigurinë e jetës.
- Autoriteti kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.

Rregulla për tu zbatuar

- Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të këtij shërbimi.
- Gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe pastrimit gjatë ditës të trotuareve i ndalohet kategorikisht hedhja e mbeturinave në pusetat e elektrikut, telefonisë, të ujësjellësit, ujrave të zeza, hidrantëve, në zgarat e pusetave të ujrave atmosferike, në shtretërit e ujrave rrjedhëse zonat e gjelbra, në burimet ujore natyrale apo artificiale, etj. Në rast të konstatimit të kësaj dukurie operatori i shërbimit detyrohet t'i pastrojë menjëherë. Në rast të përsëritjes apo mospastrim të tyre brenda 5 orësh nga marrja e njoftimit, përveç përgjegjësisë së mbartjes së shpenzimeve përballet me penalitete sipas kësaj kontrate dhe ligjeve e vendimeve në fuqi për ndotjen e shkaktuar.
- Të gjitha lëndët dizifektuese dhe aromatike si dhe uji i përdorur për larjen dhe dezifektimin e kontenierëve, pra përbërja dhe leja e përdorimit e të tyre duhet të miratohet më parë nga organet shtetërore shëndetësore.

Mjetet dhe pajisjet

- **2 (dy) Makina veteshkarkuese** me kapacitet mbajtës jo më pak se 6 konteinerë
- Solucion lares dhe desinfektues
- Çdo punëtor duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastike, çizme pune për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.
- Cdo punëtor duhet të jetë i pajisur me univorma dalluese pune fosforeshente duke qene qe jane te ekspozuar ndaj levizjes se automjeteve apo aksidenteve te mundshme rrugore.

Mjetet dhe pajisjet

- Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, jo më pak se **1 (një) copë**, dhe me kapacitet mbajtës jo më pak se 6 konteinerë.
- Lëndë dezifektuese dhe aromatizuese (dezifektues kimik) për dezifektimin e kontenierëve.
- Operatori i shërbimit duhet të ketë të instaluar në autoparkun e tij depozitë uji dhe një tjetër për lëndën dezifektuese si dhe mjete pune (pompë dhe pistoleta uji) për larjen me presion dhe dezifektimin e kontenierëve.
- Dezifektimi dhe deratizimi kryhet me dizifektues kimikë të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Mirëmbajtja e vendgrumbullimeve të mbetjeve gjatë ditës dhe grumbullimi i mbetjeve inerte dhe të vëllimshme.

Volumet e punimeve

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht të gjitha pikat e grumbullimit të mbetjeve dhe vendosjen e **144** kontenierëve 1.700 litra ose **86** vendgrumbullime mbetjesh. Shërbimi i mirëmbajtjes gjatë ditës dhe grumbullimi i mbetjeve inerte dhe të vëllimshme, do të kryhet në të gjitha pikat e grumbullimit si dhe në gjithë hapësirat publike e territoriale të zonës së kontratuar.

Këto janë paraqitur në listën e pikave të vendosjes së kontenierëve për grumbullimin e mbetjeve në zonën Perendimore 1 si dhe në hartën bashkëngjitur kësaj kontrate.

Ky shërbim do të kryhet cdo dite përgjate 156 diteve në vit ne orarin 08.00-16.00

Metodologjia e punës dhe rregulla për zbatim.

Shërbimi i mirëmbajtjes së pikave gjatë ditës dhe grumbullimi i mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme, konsiston në:

- Mirëmbajtjen dhe pastrimin gjatë ditës të mbetjeve urbane të hedhura dhe depozituara jashtë kontenierëve, mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme të depozituara në zonën e kontraktuar, si dhe të mbetjeve urbane voluminoze (ambalazhe) që tejmbushin artificialisht kontenierët dhe pengojnë mbetjet e tjera urbane për t'u depozituar nëpër kontenierë, në mënyrë që të gjitha pikat dhe kontenierët të jenë të pastër në vazhdimësi gjatë gjithë ditës. Nuk ka kufizime në pastrimin e sipërfaqes rreth kontenierit dhe operatori i shërbimit është i detyruar të largojë çdo mbetje urbane në të gjithë zonën e kontraktuar sado larg kontenierit të jetë jetë hedhur.
- Ky shërbim kryhet me anë të mjeteve vetëshkarkuese të vogla dhe të hapura që qarkullojnë nëpër të gjitha pikat e grumbullimit të zonës së kontraktuar për të mbledhur dhe larguar çdo papastërti që hidhet dhe depozitohet jashtë kontenierëve. Sipas nevojave që mund të ketë çdo pikë mund të jetë e nevojshme pastrimi disa herë në ditë të pikave dhe kontenierëve mbi të cilët në vazhdimësi ndotet gjatë orëve të ndryshme të ditës.
- Mbas pastrimit kontenierët kthehen në vendqëndrimin e tyre të mëparshëm.
- Të gjitha mjetet e vogla mund të shkarkohen në autoparkun e operatori i shërbimit, në njëren prej makina transportuese me kompaktim për të mënjeluar shkarkimin e këtyre mjeteve direkt në fushën e depozitimit në mënyrë që te ulet kosto operacionale e shërbimit.
- Përdorimi i uniformave për punëtorët që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyrueshëm dhe në rast moszbatimi aplikohen gjoba për mosplotësim këtij detyrimi.

26.3.3 Mjetet dhe pajisjet

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për kryerjen e këtij shërbimi, këto mjete dhe pajisje:

Makina e nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave urbane dhe mbetjeve ndërtimore, të vëllimshme si dhe shërbimeve mbështetëse, të kërkuara për realizimin e kontratës, janë të renditura si më poshtë:

1. Makinë e vogël transportuese, vetëshkarkuese (gazelona), me kapacitet mbajtës 1-3 ton jo më pak se **2 (dy) copë**;
1. Vegla pune si lopata, fshesa për të gjithë shoferët dhe punëtorët.

8 Lagia e rrugëve me makinë teknologjike

Volumet e Punimeve

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët dhe sipërfaqet e tyre që do të lahen me presion për të gjithë zonën e kontraktuar si për shërbimin e parë të larjes gjatë natës.

- Operatori i shërbimit do të bëjë larjen me presion të rrugëve me makinë teknologjike, si shërbim një herë në ditë gjatë natës, parashikuar në metodologji për të gjitha rrugët dhe sheshet e përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet, në një sipërfaqe të përgjithshme prej **31656 m²** në ditë.
- Frekuenca e këtij shërbimi do të jetë **100** ditë në vit përgjatë periudhës së ngrohtë.

Specifikimet teknike dhe metodologjia

Shërbimi i lagies së rrugëve me presion, me makineri teknologjike konsiston në:

- Lagien me presion me makineri teknologjike larëse, si shërbim një herë në ditë, të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve dytësore të parashikuara, në mënyrë që makinat larëse të mbulojnë me shërbim të gjitha sipërfaqet e plota të tyre brenda kohës së parashikuar.
- Gjatë shërbimit të lagies së rrugëve, shpejtësia e operimit të makinave larëse gjatë procesit të larjes (zbrazjes së ujit) duhet të variojë nga 8-10 km/orë.

Plani i Punës dhe grafikët e punimeve

- Lagia e rrugëve, si shërbim një herë në ditë, do të bëhet çdo ditë, gjithmonë mbas shërbimit të pastrimit (fshirjes) të rrugëve, nga ora 24.00-07.00.
- Në ditët që konstatohen reshje, shërbimi i lagies së rrugëve nuk do të kryhet dhe si rrjedhim nuk do të paguhet.
- Përfaqësuesit e Autoritetit kontratues do të shënojnë në procesverbalet ditore dhe situacionet mujore, të gjitha ditët dhe volumet përkatëse, që për shkak të reshjeve nuk është kryer shërbimi i lagies së rrugëve dhe mund të kërkojë operatorit të shërbimit kryerjen e këtij shërbimi në ditët e tjera të vitit ose gjatë stinës së verës kur të jetë e nevojshme, në përputhje me çmimet njësi të preventivit të punimeve/kontratës.

- Operatori i Shërbimit duhet të kryejë shërbimin e larjes me presion të rrugëve duke respektuar standartin e harxhimit të 0,8 litër ujë për 1 m² rrugë për larjen e rrugëve.

Mjetet dhe pajisjet për larjen e rrugëve

Operatori i shërbimit duhet të sigurojë për realizimin e larjes me presion të rrugëve sipas përcaktimeve të kontratës, të gjitha punimet, materialet, pajisjet si dhe lejet përkatëse.

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion dhe të përdorë për plotësimin e detyrave kontraktuale të larjes së rrugëve këto mjete:

1(një) Makinë për larjen e rrugëve, (autobot) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10000 litra ujë.